



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 36
Prishtinë, më 8 nëntor 2011

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 8 NËNTOR 2011**

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Sabri HAMITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 94 deputetë. Ai i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d i t e

**1. Debat parlamentar lidhur me Raportin e progresit 2011 për Kosovën, sipas
kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së**

Kryetari, në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, tha se Grupit Parlamentar i LDK-së ka parashtruar në Kuvend kërkesën për debat parlamentar lidhur me Raportin e progresit 2011, të Komisionit Evropian, për Kosovën. Kryetari ftoi kryetarin e Grupit Parlamentar të LDK-së, deputetin Ismet Beqiri, për prezantimin dhe arsyetimin e kërkesës për debat.

Ismet Beqiri, fillimisht tha se kërkesa e Grupit Parlamentar të LDK-së, për debat parlamentar lidhur me Raportin e progresit 2011, të Komisionit Evropian, për Kosovën ka hasur në përkrahje edhe të grupeve tjera parlamentare në Kuvend.

Përmes këtij debati të kërkuar synojmë t'i informojmë qytetarët e Kosovës se çka përmban Raporti i progresit për Kosovën, në kuptim të asaj se cila është e vërteta rreth këtij raporti.

Për LDK-në ky raport ka qenë i pritshëm, është shqetësues dhe, si i tillë, këtij raporti më së paku i atribuohet fjala progres, tha ai.

Më tej, deputeti Beqiri u fokusua, siç tha ai, në disa parregullsi të cilat evidentohen në Raportin e progresit, me theks të veçantë në zgjedhjet e fundit parlamentare në Kosovë, ku si rezultat i këtij procesi zgjedhor kemi një qeveri e cila po e çon vendin drejt politikave të gabuara buxhetore, drejt dështimeve në procesin e privatizimit, instalimit të bordeve me përfaqësues politik, rritjes së numrit të ministrive, ndërhyrjeve politike në sistemin gjyqësor, presionit ndaj gazetarisë hulumtuese, gjendjes në sektorin e shëndetësisë etj.

Më pas, ai në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, i propozoi seancës plenare disa rekomandime për miratim në fund të debatit për këtë çështje, të cilat janë dhënë të plota në transkript.

Kryeministri **Hashim Thaçi**, në fillim të fjalës së tij falënderoi Grupin Parlamentar të LDK-së për iniciativën e ndërmarrë për këtë debat, si dhe të gjitha grupet tjera parlamentare në Kuvend të cilat e kanë përkrahur një kërkesë të tillë.

Ai theksoi se do të dëshironte që ky debat të mos përdoret për fushatë parazgjedhore, dëshiron të kuptohet qartë e vërteta dhe të bëhet dallimi se Raporti i progresit për Kosovën nuk është raport për Qeverinë e Kosovës dhe se pushtetet në sistemin tonë janë të ndara.

Më tej, kryeministri tha se Qeveria e Republikës së Kosovës ka mirëpritur këtë raport, duke e vlerësuar si pasqyrë të zhvillimeve njëvjeçare, por edhe si një udhërrëfyes për Kosovën, në zbatimin e politikave të integriteteve evropiane, ndërsa gjetjet në Raportin e progresit për Kosovën janë në pajtim me zhvillimin e institucioneve në vend.

Më pastaj ai u fokusua në sfidat të cilat dalin nga ky raport, duke potencuar me theks të veçantë mungesën e marrëdhënieve konrtaktuale me BE-në, ndërsa duke folur për të arriturat për periudhën kohore për të ciklën bën fjalë Raporti i progresit, kryeministri theksoi progresin që është arritur veçanërisht lidhur me hapjen e dialogut për liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Duke folur në lidhje me përkushtimin e institucioneve të vendit lidhur me agjendën evropiane, ai përmendi po ashtu se Plani i Veprimit për Partneritet Evropian për vitin 2012, do të finalizohet më së largu deri në janar të vitit të ardhshëm, apo 6 muaj më parë se ato të viteve paraprake.

Agjenda evropiane nënkupton edhe përmirësimin e standardeve të brendshme të cilat po mundohemi t'i arrijmë, disa nga të cilat janë: reformat në administratën publike, reformat në gjyqësor, kontrolli financiar etj, tha kryeministri Thaçi.

Lutfi Haziri, kryetar i Komisionit për Integritete Evropiane, fillimisht foli për aktivitetet e komisionit që ai drejton, ndërsa duke folur për agjendën evropiane të Kosovës, theksoi mes tjerash se rrugë të shkurtër të integritetit evropian për shtetin e Kosovës nuk ka.

Duke folur më pas rreth sfidave që dalin nga ky raport, ai përmendi reformat në administratën publike, çështje kjo e cila çon në hapjen e dialogut me partnerët social.

Në fund, ai theksoi se në rrugëtimin tonë drejt integritimeve evropiane kemi obligim që të gjithë të kontribuojmë për hapjen e perspektivave të reja.

Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se raporti për të cilin po flasim sot paraqet problemet e trashëguara në të kaluarën, problemet aktuale, por edhe arritjet e vazhdueshme që bën Kosova në drejtim të realizimit të agjendës evropiane.

Në vazhdim, ai theksoi se sot kemi rastin si pozita, ashtu edhe opozita t'u themi qytetarëve të Kosovës se po vjen dita që ata të trajtohen si qytetarë evropian.

Deputeti Grabovci, në fund përkrahu punën e Qeverisë dhe të institucioneve tjera të vendit në drejtim të proceseve të integritimit evropian.

Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, tha se për subjektin që ai përfaqëson Raporti i progresit për Kosovën nuk paraqet aspak befasi.

Më pas ai u fokusua për të gjeturat e këtij raporti, duke përmendur disa nga to, si: korrupsionin, dobësitë e shumta në sektorin e shëndetësisë, në dogana, në polici, ndikimet politike, mos aftësinë e Qeverisë në fushën e politikave ekonomike, në fushën e stabilitetit makro-ekonomik, menaxhimin e dobët etj.

Ai më tej theksoi se kësaj Qeverie i mungon strategjia për ta bërë Kosovën shtet sovran.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, foli për një mori të gjeturash nga Raporti i progresit, të cilat kanë të bëjnë me gjendjen reale në Kosovë.

Më pas ai u fokusua në aspekte krahasuese në disa fusha nga Raporti i progresit i këtij viti, me ata të viteve paraprake.

Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, fillimisht tha se do të dëshironte që debati i sotëm të shkojë në favor të përmirësimit të parametrave të cilët do të dalin nga Raporti i progresit për vitin e ardhshëm.

Më pas, duke u fokusuar në agjendën evropiane të Kosovës, ajo theksoi mes tjerash se standardet që duhet t'i arrijmë në këtë drejtim, në radhë të parë ato duhet t'i arrijmë për vetveten.

Petar Miletqi, në emër të Grupit Parlamentar SLS, fillimisht përkrahu kërkesën e Grupit Parlamentar të LDK-së për debat parlamentar lidhur me Raportin e progresit për Kosovën, për të vlerësuar se në çfarë shkalle të këtyre angazhimeve qëndrojmë ne si Kosovë.

Më pas ai u fokusua në të arriturat që janë bërë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së minoriteteve në Kosovë, të cilat dalin nga ky raport. Në këtë kontekst ai ritheksoi politikat e drejta që ka udhëhequr subjekti politik SLS në drejtim të bashkëpunimit dhe integritimit të komunitetit serb që jeton në Kosovë, në institucionet e Kosovës.

Fikrim Damka, emër të Grupit Parlamentar “6+”, tha se ky raport evidenton se në disa fusha ka pasur përparime, ndërsa si sfida kryesore përmendi sundimin e ligjit dhe shtrirjen e sovranitetit në veri të vendit, si dhe rritjen ekonomike.

Deputeti Damka më pas u fokusua edhe në aspekte të përfaqësimit të komunitetit turk në institucione shtetërore dhe në ndërmarrjet publike në Kosovë.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhanë edhe deputetët: Aurora Bakalli, Vjosa Osmani, kryeministri Hashim Thaçi, ministri Bedri Hamza, Donika Kadaj-Bujupi, ministri Ferid Agani, Skënder Hyseni, ministri Besim Beqaj, Florin Krasniqi, Naser Osmani, Blerim Shala, Arsim Bajrami, Glauk Konjufca, Teuta Sahatqija, ministri Bajram Rexhepi, Afërdita Berisha-Shaqiri, Kurtan Kajtazi, Alma

Lama, Kimete Bytyqi, Blerta Deliu-Kodra, Suzana Novoberdaliu, ministri Mahir Yagcilar, Time Kadrijaj, Rexhep Selimi, Hashim Deshishku, zv. kryeministri Hajredin Kuçi, Venera Dibra, Duda Balje, Haki Demolli, Xhevdet Neziraj, Afrim Kasolli, Sali Morina, Fadil Demaku, Albert Kinolli, Burim Ramadani, Halit Krasniqi, Bahri Thaçi, Ramë Vataj, Lirije Kajtazi, Hydajet Hyseni, Teuta Haxhiu, Sala Berisha-Shala, Rita Hajzeraj- Beqaj, Gëzim Kelmendi, Anton Quni, Bekim Haxhiu, Ardian Gjini, Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Jeton Svirca, Ganimete Musliu, Sadri Ferati dhe ministrja Vlora Çitaku, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari, pas përfundimit të diskutimeve, konstatoi se në sallë janë të pranishëm 55 deputetë, kështu që nuk ka kuorum për t'i votuar rekomandimet e propozuara nga GP i LDK-së.

Deputeti Ismet Beqiri propozoi që rekomandimet e Grupit Parlamentar të LDK-së të hidhen në votim në mbledhjen e radhës.

Në fund, kryetari konstatoi se rekomandimet e Grupit Parlamentar të LDK-së nuk kanë qenë pjesë e mocionit për debat, por ia vlen që ato të votohen dhe Kuvendi do të vendos në mbledhjen e radhës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kuvendit në orën 19:00.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale